

- GJETJET E KSHH NGA MONITORIMI PREJ ORES 1300- 1700

Komiteti Shqiptar i Helsinkit po vazhdon monitorimin ne 9 Qarqe, ose 25 Bashki te vendit si, Tirane, Durres, Kukes, Shkoder, Elbasan, Fier, Vlore, Korçe, Gjirokastrë.

Kemi konstatuar se procesi vijon qetësisht, por nuk kanë munguar shkeljet e ligjit nga komisionerët, vëzhguesit politikë ose ndonjë shtetas(zgjedhës) sporadik.

Ndër parregullsitë ligjore të konstatuara, pas njoftimit të parë të kryer në orën 1300, përmendim:

- Vazhdojnë problemet me bazën materiale. Në QV nr. 1459, Durrës dhe në një QV nr. 1266 në Krujë, anëtarë të KZAZ-së përkatëse kanë tërhequr nga 100 fletë votimi, të pa përdorura, duke pretenduar se nevojiteshin për QV në institucionet e vuajtjes së dënimeve penale. Gjithashtu janë konstatuar raste ku cilësia e bojës timbruese është e ulët dhe ajo fshihet menjëherë.
- Janë vërejtur raste të mangësive në procedurën e votimit të personave me aftësi të Kufizuar, duke mos pasqyruar me shkrim, sipas ligjit, rastet e ofrimit të ndihmës për këtë kategori zgjedhësish. Këto shkelje janë vërejtur në Q.V 2110 dhe 2115, 4591 etj.
- Jane konstatuar simbole të subjekteve politike, kryesisht materiale propagandistike të PS dhe LSI, pranë disa QV si ato nr. 1974/1, 1974, QV pranë shkollës ”Abdulla Keta”, Liceu Artistik “Jordan Misja” etj.
- Vazhdojnë të konstatohen veprime në kundërshtim me ligjin nga ana e anëtarëve të QV. Janë konstatuar raste ku anëtarët e Qendres së Votimit, kanë përdorur telefona celulare gjatë procesit të votimit, si në QV 1703/1, ose mos kontroll i gishtave të zgjedhësve si në QV 1741/1 dhe QV 1975/ KZAZ 39, QV 1915, QV 4507/1. Janë evidentuar raste të mbajtjes së shenjave dalluese të subjekteve politike nga anëtarë të KQV (byzylyk me simbole të LSI-se) QV 1885. Janë konstatuar raste të ndërhyrjes së anëtarëve të KQV, të cilët kanë ndërhyrë duke kryer procesin e palosjes ose hedhjes në kuti të fletës së votimit të plotësuar nga zgjedhësi. Në QV 1767 – është lejuar ndihma për një zgjedhës të verbër nga një person që nuk ishte në listën e zgjedhësve të asaj QV-je;
- Vëzhguesit e KShH kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre ligjore për të prezantuar vërejtje me shkrim pranë KQV-ve në lidhje me shkeljet e sipërsënuara dhe më gjerë. Vërejtjet lidhen me lejimin e votimit familjar (QV 2041); për qëndrimin e anëtarëve të KQV pranë dhomës së fshehtësisë, ose komunikim me zgjedhësin që ndodhej në dhomën e fshehtësisë (QV 1699/1) ; për përdorim celulari brenda QV-se nr. 1699; për mos kontrollim të duhur të gishtave/timbrosjes (QV 2115); Në QV nr. 1883, 1883/1, 1910, 19101, 1911, 1911/1, 1912, 1912/1, 19122, 1914, 1914/1, 1915, 1915/1, 1916 dhe 1916/1 është konstatuar një praktikë e kundraligjshme. Pasi jepej Fleta e votimit Votuesit, Kryetari i KQV njoftonte me zë të lartë emrin, mbiemrin e votuesit si dhe nr. rendor në listë, me qëllim që të viheshin në dijeni vëzhguesit e subjekteve zgjedhore. Komisionerët pretenduan se kështu ishin udhëzuar nga KQZ. Në QV nr. 1883/1 është konstatuar se

dhoma e fshehtë e votimit ishte vendosur në mënyrë të tillë që mund të dallohej nga hyrja në QV-së, duke krijuar kushte për cënimin e fshehtësisë së votës.

- Disa prej vërejtjeve të monitoruesve të KShH janë mirëpritur nga KQV përkatëse dhe shkeljet janë korigjuar menjëherë, por ka patur raste të sjelljes arogante të komisionerëve, të cilët kanë refuzuar të marrin vërejtjen me shkrim të vëzhguesit, por dhe kanë komunikuar me gjuhë të ashpër me ta psh në QV nr. 1691/1, tek Shkolla Nëntëvjecare “Ali Demi”, ZAZ nr. 31, Bashkia Tiranë, ku është tentuar dhe për ta nxjerre jashtë nga QV vëzhguesin përkatës, në kundërshtim me n 106, të Kodit Zgjedhor.
- Vazhdon të konstatohen sjellje në kundërshtim me ligjin të zgjedhësve të veçantë si fotografimi i votës është një shkelje që është manifestuar në disa raste si QV 1728 etj.

Me respekt,

Vjollca Meçaj
Drejtoreshë Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit